



**GRUPI  
KËSHILLIMOR  
I STABILITETIT  
FINANCIAR**

Tiranë, në 19.03.2014

## **NJOFTIM PËR SHTYP**

**Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar,**

**10 mars 2014**

---

Në datën 10 mars 2014, u zhvillua mbledhja e rregullt e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Nënkyetarja e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të shoqëruar nga drejtues të tjerë të këtyre institucioneve. Në mbledhje ishte i ftuar dhe mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Në fillim të mbledhjes, të pranishmit u njohën me një përmbledhje të rekomandimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) që kreu vlerësimin e sektorit financiar shqiptar në periudhën tetor-nëntor 2013 (FSAP). Rekomandimet kanë të bëjnë me përmirësime në kuadrin e mbikëqyrjes së institucioneve financiare, duke u përqendruar te veprimet që rrisin kapacitetet e autoriteteve mbikëqyrëse për ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar. GKSF-ja diskutoi mbi këto rekomandime dhe vuri në dukje nevojën e përgatitjes së një plani veprimi të koordinuar në nivel ndërinstitucional për realizimin e këtyre rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara, duke pasur parasysh që një pjesë e tyre përfaqësojnë angazhime të autoriteteve shqiptare në marrëveshjet për financim me FMN-në dhe BB-në. Rekomandimet e mësipërme përfshijnë edhe rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ekzistues mes Ministrisë së Financave (MF), Bankës së Shqipërisë (BSH), Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencisë së

Sigurimit të Depozitave (ASD) me qëllim forcimin dhe fokusimin e bashkëpunimit për çështjet e trajtimit të rreziqeve sistemike për sistemin financiar, si dhe mbështetje më të mirë të punës së GKSF-së në nivel teknik. Drejtuesit e institucioneve të pranishëm në mbledhje vlerësuan se këto ndryshime janë të nevojshme për të përmirësuar më tej veprimtarinë e GKSF-së dhe nënshkruan Memorandumin e ndryshuar.

Ndër të tjera, FSAP-i rekomandoi edhe ndryshimin e disa ligjeve që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ASD-së dhe të AMF-së, si edhe veprimtarinë e disa subjekteve financiare që monitorohen prej tyre. Në prezantimet e tyre, përfaqësues të ASD-së dhe të AMF-së, vlerësuan se këto ndryshime ligjore të përgatitura e sjellin veprimtarinë institucionale dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare më pranë standardeve më të mira ndërkombëtare në fushat përkatëse dhe theksuan nevojën për finalizimin e tyre.

Në vijim, përfaqësues të BSH-së bënë një paraqitje të gjendjes financiare të sektorit bankar deri në fund të vitit 2013. U theksua se sektori paraqitet i mirëkapitalizuar e likuid dhe që rezultati financiar pozitiv është pothuajse i dyfishuar në krahasim me një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e rezultatit financiar e kanë dhënë ngadalësimi i ndjeshëm i rritjes së kredive me probleme dhe i provigjioneve për rrezikun e kreditit, duke ulur, kështu, shpenzimet e veprimtarisë. GKSF-ja vlerësoi se ecuria e kreditimit vijon të ndikohet nga disa probleme strukturore që përfshijnë eficiencën e procesit të ekzekutimit të kolateralit, trajtimin tatimor të fshirjes nga bilanci të kredive të humbura, nevojën e ristrukturimit të bizneseve dhe kërkesën e paqëndrueshme për kredi. GKSF-ja vlerësoi, gjithashtu, se përmirësimet ligjore që janë kryer dhe po kryhen, do t'i adresojnë më mirë këto probleme, dhe theksoi nevojën për ta trajtuar këtë çështje në bashkërendim me institucione të tjera.